



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



<b>Për :</b>	<b>Autoritetet Kontraktuese</b>	<b>Niveli</b>	<b>Kopja:</b>	<b>Arkivi i KRPP- së</b>
<b>qendror</b>				
<b>Nga:</b>	<b>Bordi i KRPP-se</b>			
<b>Lënda:</b>	<b>Kërkesë lidhur me zbatimin e Platformës së e-prokurimit</b>			
<b>Datë:</b>	<b>29.08.2016</b>			

Të nderuar,

Ne mbështetje të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.12/79 datë 15.03.2016 dhe në funksion të funksionalizimit të platformës së prokurimit elektronik nga data 01.09.2016 do të fillojë aplikimi i platformës së e-prokurimit për të gjitha autoritetet kontraktuese në nivelin qendrorë.

Andaj, KRPP kërkon nga të gjitha autoritetet kontraktuese në nivelin qendrorë që të fillojnë përgatitjet intensive për aplikimin e platformës nga data e cekur më lart.

Me qëllim të lehtësimit të hapave që do të ndiqen në procedurat elektronike, KRPP do të asistojë dhe përkrah autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik pjesë e platformës përmes **Tavolinës ndihmese** (kontaktet do të vendosen në web-faqen e KRPP-së dhe platformën elektronike <http://e-prokurimi.rks-gov.net>).

Në këtë proces do të përfshihen në mënyrë elektronike të gjitha procedurat e prokurimit publik me vlera të mëdha dhe të mesme.

Andaj, autoritetet kontraktuese dhe Operatorët ekonomik janë të obliguar që të ndjekin detyrimet e shënuara më poshtë lidhur me procedurat e regjistrimit në platformën elektronike, qasjen në sistem dhe procedurat e operimit. Operatorët ekonomik janë të obliguar të regjistrohen në platforme dhe dorëzojnë tenderin në kopje elektronike ose fizike, por jo në të dy versionet njëherësh. Pa varësisht nga kjo inkurajohen OE të dorëzojnë ofertat e tyre në versionin elektronik sepse është shumë me efikas dhe se shumë shpejt kjo do të jetë forma e vetme e dorëzimit të ofertave.

Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në FTD të Dosjes së Tenderit, nëni 19.1.h, që tenderi të dorëzohet në njërin nga format "**në mënyrë elektronike ose fizike**" (**ne asnjë mënyrë në të dy versionet**). Përveç kësaj AK do të kushtojë një vëmendje të shtuar njoftimit në cilën do të mënyrë tjetër të OE që të dorëzojnë **ofertën elektronike për të**



inkurajuar kalimin ne këtë forme por kjo nuk do te jete kusht i tenderit i cili duhet respektuar për te mundësuar pranimin si te “përgjegjshme” administrativisht oferta e tille. Pra, cilën do forme te cilën ofertuesi e zgjedhe ajo do te pranohet e vlefshme deri ne nje vendim tjetër (te KRPP-se).

Autoritetet kontraktuese do te përgatisin dhe publikojnë te gjitha Njoftimet ne platformën elektronike ndërsa KRPP do te kujdeset qe te njëjtat te publikohen edhe ne web faqen zyrtare te KRPP-se (aktuale). Autoritetet kontraktuese nuk do te kenë asnjë obligim ligjore për web faqen e KRPP-se e cila do te administrohet nga KRPP dhe kjo d te behet vetëm për një periudhe e cila do te vlerësohet e mjaftueshme si mase tranzicioni nga prokurimi tradicional ne atë elektronik. Operatorët ekonomik do te mund te shkarkojnë dosjet përkatëse vetëm nga platforma elektronike. Autoriteti përkatës kontraktues nuk kanë asnjë obligim qe ofertuesve tu dërgojnë Dosjen e Tenderit dhe/ose cilin do informate/sqaruese përveç përmes platformës elektronike.

Ne vazhdim nga ajo qe u cek me lart; Autoritete kontraktuese do te përcaktojnë qarte afatin për pranimin e ofertave ne mënyrë elektronike dhe hard copy. Afati për pranim te ofertave duhet te jete identik – pra koha e përcaktuar si afat për dorëzim te ofertave është e njëjtë për te dy versionet e ofertave. Gjithashtu autoritetet kontraktuese duhet te përcaktojnë/specifikojnë qe hapja e ofertave për te dy versionet do te behet ne te njëjtën kohe, duke specifikuar qe procedura e hapjes se ofertave është si ne vijim: se pari behet hapja e ofertave ne versionin elektronik e te **gjitha ofertave** (oferta elektronike), dhe **menjëherë** pas fillon dhe kryhet hapja e ofertave ne kopje fizike. Për qëllime transparence dhe për te plotësuar kërkesat ligjore AK do te ftoj me kohe OE (tenderuesit) qe te marrin pjese ne hapjen publike te ofertave ne te dy versionet .

Me qellim qe autoritetet kontraktuese dhe/ose operatorët ekonomik te përgatiten me lehtë (ne forme tranzicioni) kalimi nga prokurimi tradicional (kopje fizike) ne atë elektronik, procesi i tenderimit për një periudhe te caktuar do të kryhet në dy versionet: elektronike dhe kopje fizike. Sipas kësaj, te gjitha aktivitetet e prokurimit per vlera te mesme dhe te mëdha ne nivelin qendror do te kryhen përmes platformës elektronike, mirëpo procesi i dorëzimit te ofertave do te mundësohet te behet sipas përcaktimit te operatoreve ekonomik pjesëmarrës ne aktivitetet ne fjale ( ne formën elektronike ose fizike).

### **Detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

Për të aplikuar platformën elektronike të prokurimit, autoriteti kontraktues ka obligimet si në vijim:

- Të regjistrohet në sistemin elektronik të prokurimit publik;
- Të bëjë publikimin e Njoftimit për Kontratë në Platformën elektronike: <http://e-prokurimi.rks-gov.net> (E njëjta do te publikohet nga KRPP edhe ne web faqen e KRPP-se (mënyra e deri tanishme).
- Të vë në dispozicion për përdoruesit Dosjen e Tenderit në Platformën elektronike;\
- Në Dosjen e Tenderit të ceket si kërkesë administrative, që ; “Tenderi të dorëzohet në mënyrë elektronike ose në kopje fizike”.



- Kërkesa e specifikuar me lartë duhet bere me dije ofertuesve (ne dosjen e tenderit por edhe ne forma tjera) ne mënyrë qe at ata jene te njoftuar me kohe.
- Të bëjë hapjen publike edhe të ofertave elektronike në prani të operatorëve ekonomik. Fillimisht, AK do te hape te gjitha ofertat e dorëzuara me formën elektronike dhe menjëherë me pas do te filloj hapja te gjitha ofertave ne formën “hard copy”.
- Te kryejë vlerësimin e ofertave ne te dy versionet dhe te plotësoj te gjithë veprimet e nevojshme ne te dy versionet
- Kontrata do te lidhet me OE i cili ka dorëzuar ofertën me te mire ne cilindo version ( mënyra e dorëzimit nuk do te ketë asnjë ndikim ne vlerësim)

### **Detyrimet e operatorëve ekonomik**

- Të gjithë operatorët ekonomik qe shprehin interes ne pjesëmarrje ne procedurat e tenderimit te shpallur nga Autoritetet Kontraktuese (ne nivelin qendror), **janë te obliguar te regjistrohet në sistemin elektronik të prokurimit publik;**
- Procedurat e regjistrimit duhet te jene ne pajtueshmëri te plote me procedurat/hapat e specifikuar ne **Manualin për regjistrim te Operatoreve Ekonomik**. Manuali për regjistrim te operatoreve ekonomik është i dispozicion dhe mund te shkarkohet nga web-faqja e platformës elektronike <http://e-prokurimi.rks-gov.net> si dhe ne web faqen zyrtare te KRPP-se. Gjate procesit te regjistrimit, për çfarëdo paqartësie, operatorët ekonomik mund te kërkojnë ndihme rreth regjistrimit edhe nga Tavolina Ndhimese e KRPP-se, ne linjat telefonike te shënuar ne web-faqen e platformës elektronike.
- Pas përfundimit te procedurave te regjistrimit deri ne fund – operatorët ekonomik do te pranojnë një e-amil ( ne adresën elektronike e cila është përdorur ne proces te regjistrimit) ku konfirmohet regjistrimi i suksesshëm i operatorit ekonomik ne platformën elektronike.
- Operatorët Ekonomik gjate procesit te regjistrimit DUHET te kenë VEMENDJE te veçante ne saktësinë e te dhënave te obligueshme ( emrin e kompanisë, Nr. e telefonit kontaktues, ADRESEN ELEKTRONIKE, nr. e biznesit dhe nr. fiskal) dhe sidomos EMRIN E PERDORUESIT ( User Name) dhe FJALEKALIMIN ( Passwordi) për qasje ne sistem. Për çfarëdo suate ne te cilën qasja ne sistem ka qene e pamundur për shkak te humbjes ose harresës se emrit te përdoruesit ose fjalëkalimit, përgjegjësia është e Operatorit Ekonomik. Prandaj, operatorët ekonomik sugjerohen qe gjate procesit te regjistrimit, **Emrit i Përdoruesit dhe Fjalëkalimit** te shënohen dhe te ruhen me përgjegjësi.
- Pas aktivizimit te qasjes, te gjitha procedurat për shfrytëzim dhe përdorim te platformës elektronike - Operatorët Ekonomik mund ti gjejnë ne manualin për përdorim te platformës elektronike nga ana e Operatoreve Ekonomik (Udhëzimet për ofertim përmes platformës). Përveç manualit, operatorët ekonomik mund te kërkojnë ndihme dhe sqarime te nevojshme edhe nga Tavolina Ndhimese e KRPP-se.
- Ne autoritetet kontraktuese te cilat përdorin platformën elektronike operatorët ekonomik janë te obliguar qe ofertat e tyre ti dorëzojnë ne njërin version – versionin e ofertës ne forme elektronike ose versionin e ofertës ne forme fizike por ne asnjë



mënyrë të dy versionet sepse do të ketë pengesa në fazën e vlerësimit (ofertat e tilla mund të konsiderohen jo të përgjegjshme në rast se kanë cilëndo mospërputhje).

- Operatorët ekonomik të vendosin të dorëzojnë edhe me tej ofertat e tyre në formë fizike, sugjerohen që ofertën ta plotësojnë drejtpërdrejt në platformë dhe të njëjtën ta printojnë, nënshkruajnë, vulosin dhe dorëzojnë në formë fizike.

